



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
ZËVENDËSMINISTRI

Nr. 6431/1 Prot.

Tiranë, më 11.07.2019

URDHËR

Nr. 388 datë 11.07.2019.

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË LËNDËS “HISTORI” PËR KLASËN E NËNTË,
NJËMBËDHJETË DHE TË DYMBËDHJETË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 25 dhe 26, të ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e programeve të lëndës “Histori” për klasën e nëntë, njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Programet e lëndës “Histori” për klasën e nëntë, miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 11008/6 prot., datë 16.11.2017; për klasën e njëmbëdhjetë nr.12816/13 prot., datë 28.12.2017; për klasën e dymbëdhjetë miratuar me nr.17090/4., datë 20.12.2016, shfuqizohen.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar si dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTËR

Redi SHTINO

